



KOSOVA DHE SERBIA PAJTOHEN RRETH PROPOZIMIT EVROPIAN

KURTI PRANON PROPOZIMIN EVROPIAN PA NJOHJE, E MERR OBLIGIM ZBATIMIN E ASOCIACIONIT.



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, kanë rënë dakord të hënën në Bruksel për planin evropian, i cili e përmban Asociacionin e komunave

me shumicë dhe marrëveshjet e mëhershme në kuadër të dialogut. Në deklaratën e lëshuar pas takimit, shefi i politikës së jashtme të BE-së, Josep Borrell ka bërë me dije se palët

shprehën gatishmërinë e tyre për të vazhduar me zbatimin e kësaj marrëveshje, duke paralajmëruar takimin e radhës mes Kurtit dhe Vuçiqit në muajin mars

OPINION

PROPOZIMI FRANKO-GJERMAN ME NË QENDËR NJOHJEN FORMALE TË... BANGLADESHIT



Behxhet Sh. SHALA-BAJGORA

AKTUALE



INVESTIMET GLOBALE TË BEI-t NË BALLKANIN PERËNDIMOR ARRITËN VLERËN 824 MILIONË EURO NË VITIN 2022

DY TË VDEKUR NGA COVIDI, IKSHPK-ja BËN APEL: BARTNI MASKAT NË AMBIENTE TË MBYLLURA

EKONOMI



DOGANA E KOSOVËS AUTORIZON KOMPANINË E TETË SI OPERATORE EKONOMIKE

SPORT



FBK-ja ORGANIZON FIBA 3X3 U23 NATIONS LEAGUE

PSD-ja, AKSION PARA OBJEKTIT TË QEVERISË: TENSION PËR ASOCIACION



LIDERI I PDK-së: ËSHTË ULUR NUMRI I NXËNËSVE PËR SHKAK TË EMIGRIMIT MASIV



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Një i vdekur, 69 të lënduar nga tërmeti i fundit në Turqi

MALLATJA, 27 SHKURT - Një tërmet 5.6 shkallë i Rihterit e ka goditur të hënën Turqinë, duke lënë një person të vdekur dhe 69 të lënduar. Disa ndërtesa janë rrëzuar nga tërmetet paraprake. Tri javë më parë Turqia dhe Siria janë goditur nga dy tërmete mbi 7 shkallë të Rihterit, të cilat kanë lënë mbi 50 mijë njerëz të vdekur dhe qindra mijëra ndërtesa të shkatërruara. Tërmeti i 27 shkurtit e ka pasur epiqendër qytezën Jesiljurt në provincën Mallatja, ka thënë Agjencia Shtetërore për Menaxhim të Katastrofave. Kryetari i qytezës, Jesiljurt, Mehmet Cinar, u ka thënë

medieve turke se një numër ndërtesash janë rrëzuar, përfshirë një ndërtesë katërkatëshe, ku kanë mbetur të bllokuar një baba me vajzën e tij. Ekipet e kërkim-shpëtimit janë duke vazhduar punën për të gjetur njerëzit që mund të kenë mbetur nën rrënoja. Mallatja është në mesin e 11 provincave turke që janë goditur nga tërmetet e 6 shkurtit. Agjencia turke për Menaxhim të Katastrofave ka thënë se pas tërmeteve mbi 7 shkallë, rajoni jugor turk është përballur me mbi 10 000 pasgoditje.



Izraeli dhe palestinezët zotohen për ulje të dhunës



JERUSALEM, 27 SHKURT - Qeveria izraelite dhe Autoriteti Palestinez kanë lëshuar një deklaratë të përbashkët për marrjen e hapave që çojnë në ulje të dhunës. Kjo deklaratë

është lëshuar të dielën, pas bisedimeve të rralla mes dy palëve, që janë zhvilluar në Jordani, në të cilat kanë marrë pjesë edhe zyrtarë nga Shtetet e Bashkuara dhe Egjipti.

Në takim është arritur pajtueshmëri për të bërë hapa drejt rritjes së besimit dhe për të punuar drejt "paqes afatgjatë". Në kohën e nisjes së bisedimeve, një sulmues

palestinez ka qëlluar për vdekje dy izraelitë në Bregun e pushtuar Perëndimor. Ushtria izraelite ka thënë më vonë se do të shtojë dy batalione shtesë për rritje të sigurisë. Si përgjigje, kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu, ka thënë se administrata e tij "do të vazhdojë të bëjë gjithçka për t'i luftuar terroristët dhe për ta ruajtur sigurinë e Izraelit". Këshilltari amerikan për Siguri Kombëtare, Jake Sullivan, ka thënë se ka mirëpritur zotimet e bëra nga të dyja palët, duke shtuar se duhet bërë më shumë punë në muajt në vazhdim "për të ndërtuar një të ardhme stabile për izraelitët dhe palestinezët". Grupi militant palestinez Hamas, i cili kontrollon Rripin e Gazës, e ka dënuar Autoritetin Palestinez për pjesëmarrje në ato që i ka konsideruar bisedime

"që nuk kanë vlerë". Prej fillimit të këtij viti më shumë se 60 palestinezë militantë dhe civilë janë vrarë nga forcat izraelite, ndërsa në anën izraelite është raportuar për 13 të vrarë. Tensionet janë rritur së fundi pas dy bastisjeve ushtarake izraelite në kampin Jenin të refugjatëve dhe në qytetin e vjetër Nablus në të cilat janë vrarë 21 palestinezë, duke shënuar operacionin më të përgjakshëm të këtij lloji që nga viti 2005. Në të dyja rastet ushtria izraelite ka thënë se synimi i saj ka qenë që t'i arrestojë burrat e kërkuar që, ose kanë kryer sulme, ose kanë qenë duke i planifikuar ato. Ekzistojnë shqetësime për tensione të mëtejshme, pasi në javët në vazhdim Muaji i shenjtë i Ramazanit do të shënohet në kohën e njëjtë me Pashkën Hebreje.

Kremlini: Nuk ka kushte për paqe me Ukrainën

MOSKË, 27 SHKURT - Kremlini ka thënë të hënën se e ka marrë propozimin e Kinës për zgjidhje politike në Ukrainë, mirëpo për momentin nuk ka kushte për zgjidhje paqësore për konfliktin. "Ne i kemi kushtuar shumë vëmendje planit të miqve tanë kinezë", ka thënë të hënën zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, duke shtuar se "tani për tani ne nuk shohim që i kemi kushtet drejt paqes". Kina ka synuar që ta paraqesë veten si palë neutrale në luftën e Rusisë në Ukrainë, ndonëse i ka mbajtur lidhjet e saj strategjike me Moskën. Javën e kaluar Pekini ka prezantuar një plan 12-pikësh për dhënie fund të luftës në Ukrainë, në të cilin është përfshirë respektimi i sovranitetit territorial të të

gjitha shteteve. Ministria e Jashtme ruse e ka falënderuar Kinën për përpjekjet, mirëpo ka thënë se çdo zgjidhje për konfliktin duhet ta përfshijë kontrollin e Rusisë mbi katër rajone ukrainase. Rusia pretendon se ka aneksuar rajonet ukrainase Donjeck, Luhansk, Zaporizhja dhe Herson, mirëpo nuk i ka kontrolluar ato asnjëherë plotësisht. Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, ka thënë se shteti i tij duhet të punojë me Kinën, duke argumentuar se i duket që ky shtet "ka respekt për integritetin territorial dhe çështjet e sigurisë". Zelensky ka thënë, po ashtu, se është i bindur që vetëm një shtet, territori i të cilit është



duke u sulmuar, mund të iniciojë "iniciativa për paqe". Publikimi i propozimit kinez ka

ardhur pas akuzave të Perëndimit se Kina po shqyrton mundësinë e

dërgimit të armëve në Rusi. Pekini, në anën tjetër, e ka hedhur poshtë këtë pretendim.

Investimet globale të BEI-t në Ballkanin Perëndimor arritën vlerën 824 milionë euro në vitin 2022



Banka Evropiane e Investimeve (BEI) Globale investoi në projekte të reja me vlerë 835,2 milionë euro në Ballkanin Perëndimor në vitin 2022, të cilat synojnë të mobilizojnë afër 3,5 miliardë euro në investime të reja në rajon, duke kontribuar në realizimin e Planit Ekonomik dhe Investiv. Nën degën e saj të dedikuar jashtë BE-së, banka e BE-së rriti mbështetjen teknike për projektet e reja që lidhen me efikasitetin e energjisë dhe energjinë e rinovueshme

se ndikimi i financimit në rajon pasqyron angazhimin dhe këmbënguljen e Grupit të BEI-t për Ballkanin Perëndimor, të shtrirë mbi 45 vjet. “Gjatë dy vjetëve të fundit Evropa është përballur me kriza të ndërthurura që kanë shkaktuar përçarje masive socio-ekonomike. Në të njëjtën kohë, këta kanë përshpejtuar tranzicionin e gjelbër dhe digjital, duke e nxitur BEI-n t’i kthehet rolit të tij të instrumentit të politikës ekonomike kundërciklike në kuadër të nismës ‘Team Europe’ për t’i ndihmuar ekonomitë vendase të rimëkëmben më shpejt dhe ta përshtatin infrastrukturën e tyre me qëllim adresimin e sfidave kritike në të ardhmen”, ka thënë Pavlova.

Që prej vitit 2020 BEI Globale ka investuar 2,5 miliardë euro në Ballkanin Perëndimor, duke ofruar mbështetje të drejtpërdrejtë dhe konkrete për vendet, e cila i ka ndihmuar ato në kalimin afatgjatë drejt ekonomisë neutrale ndaj klimës, me energji të sigurt dhe gjithëpërfshirëse, ndërkohë që edhe ka trajtuar njëkohësisht pasojat më të menjëhershme të krizës. “Tani ne planifikojmë ta zgjerojmë përfshirjen tonë në sektorin e energjisë, duke kontribuar në paketën e mbështetjes energjetike me vlerë 1 miliardë euro të BE-së e cila u miratua në dhjetor 2022 dhe që parashikon projekte të energjisë së rinovueshme, ndërtimin dhe modernizimin e rrjetit të energjisë dhe objekteve të ruajtjes së energjisë”, ka pohuar zëvendëspresidentja Pavlova.

“Epoka e re”

Prishtinë, 27 shkurt - Banka e BE-së, nën degën e saj të dedikuar për aktivitetet jashtë Bashkimit Evropian - BEI Globale - investoi 824 milionë euro në të gjithë Ballkanin Perëndimor në vitin 2022 me qëllim të përshpejtimit dhe qëndrueshmërisë. Kjo qasje në kuadër të Team Europe mundëson shfrytëzimin maksimal të burimeve financiare në dispozicion për

investimet e nevojshme. Mbi të gjitha, banka mobilizoi grante me vlerë 11,2 milionë euro për të filluar projekte të qëndrueshme që lidhen me zhvillimin urban, efikasitetin e energjisë dhe energjinë e rinovueshme. Pjesa më e madhe e nënshkrimeve të reja është alokuar për transport më të qëndrueshëm, të sigurt dhe efikas, si dhe projektet hekurudhore dhe ujore, duke arritur në 75 për qind të totalit të kreditimit vitin e kaluar, të pasuara nga investimet në ndërmarrjet e vogla dhe të

mesme (NVM), projekte për mjedisin dhe digjitalizimi. Si një nga aktorët kryesorë të Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor (VBIF), EIB Global vazhdoi të zbatojë investime në partneritet me Komisionin Evropian, institucionet financiare ndërkombëtare dhe partnerët nga Ballkani Perëndimor. Kjo qasje brenda Ekipit të Evropës mundëson përdorimin maksimal të burimeve financiare për investimet e nevojshme. Banka e BE-së ka

hartuar gjithashtu instrumente financiare novatore, duke përfshirë përzjerjen e huave, garancive, këshillimit dhe granteve, në kuadër të Fondit Evropian për Zhvillim të Qëndrueshëm Plus (EFSD+), për t’i mbështetur bashkitë, prodhuesit e energjisë, korporatat, NVM-të dhe bankat tregtare me investime në sektorët e energjisë, lidhjes dhe digjitalizimit. Zëvendëspresidentja e BEI-t, Lilyana Pavlova, përgjegjëse për Ballkanin Perëndimor, ka thënë

Lideri i PDK-së: Është ulur numri i nxënësve për shkak të emigrimit masiv

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 SHKURT - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka vizituar të hënën Shkollën Fillore “Pjetër Bogdani” në Prishtinë, së cilës, sipas tij, sikur shumë prej shkollave të tjera në Kosovë, në dy vjetët e fundit i është ulur numri i nxënësve për shkak të emigrimit masiv. “Gjatë bashkëbisedimit, mësimdhënësit shprehën shqetësimin e tyre me trendin e dy vjetëve të fundit, ku kjo shkollë ka humbur rreth 60 nxënës, apo dy klasë. Situata bëhet edhe më alarmante kur shohim shifrat në nivel vendi, të cilat na tregojnë se për dy vjet në arsimin parauniversitar të Kosovës ka mbi 16 mijë nxënës më pak dhe plot 47 shkolla të mbyllura. Çdo ditë, të rinj të

talentuar e me potencial të jashtëzakonshëm po e braktisin vendin. Çdo ditë prindër profesionistë po i lëshojnë vendet e punës në mungesë të një të ardhmeje më prosperuese për fëmijët e tyre në Kosovë”, ka thënë Krasniqi. Ai ka thënë se sot është kritike që t’i kuptojmë dy gjëra. “Qytetarët nuk mund t’i mbajmë në vend me fjalime të bukura e premtime të mëdha. Dhe, e dyta, ne duhet të veprojmë urgjentisht dhe me prioritet që ta rikthejmë epokën e zhvillimit në vendin tonë. Kjo është beteja që duhet ta fitojmë - dhe duhet ta fitojmë së bashku, duke lënë mënjanë interesat partiake dhe politikën ditore. Ky duhet të jetë misioni ynë, për çdo parti, për çdo politikan dhe për të gjithë shoqërinë tonë”, ka theksuar ai.



Krasniqi ka thënë se Partia Demokratike e Kosovës është e përkushtuar të angazhohet për

të arritur këtë synim. “Bashkë, edhe me mësimdhënësit e përkushtuar dhe atdhedashës,

do ta kthejmë shpresën dhe besimin në Kosovë”, ka deklaruar Krasniqi.



KOSOVA DHE SERBIA PAJTOHEN RRETH PROPOZIMIT EVROPIAN

Kurti pranon propozimin evropian pa njohje, e merr obligim zbatimin e asociacionit

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, kanë rënë dakord të hënën në Bruksel për planin evropian, i cili e përmban Asociacionin e komunave me shumicë dhe marrëveshjet e mëhershme në kuadër të dialogut. Në deklaratën e lëshuar pas takimit, shefi i politikës së jashtme të BE-së, Josep Borrell ka bërë me dije se palët shprehën gatishmërinë e tyre për të vazhduar me zbatimin e kësaj marrëveshjeje, duke paralajmëruar takimin e radhës mes Kurtit dhe Vuçiqit në muajin mars

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 27 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, kanë rënë dakord të hënën në Bruksel se nuk ka nevojë për diskutime të mëtejme rreth propozimit të Bashkimit Evropian për normalizimin e marrëdhënieve mes tyre. Kështu ka bërë me dije shefi i politikës së jashtme të BE-së, Josep Borrell. Borrell dhe i dërguari i BE-së për dialogun Kosovë-Serbi, Miroslav Lajçak, pritën të hënën në Bruksel udhëheqësit e këtyre dy vendeve. Në tryezën e bisedimeve ishte propozimi i BE-së, i titulluar "Marrëveshje drejt normalizimit

mes Kosovës dhe Serbisë".

Në deklaratën e lëshuar pas takimit, Borrell tha se palët shprehën gatishmërinë e tyre për të vazhduar me zbatimin e kësaj marrëveshjeje. "Nevojiten negociata të mëtejshme për të përcaktuar modalitetet specifike të zbatimit të dispozitave", ka thënë Borrell, duke paralajmëruar takimin e radhës mes Kurtit dhe Vuçiqit në muajin mars.

Propozimi i BE-së përfshin zotimin e palëve për t'i respektuar të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tani në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve, si dhe përkushtimin e tyre për të mos e penguar njëra-tjetrën në proceset integruuese. Marrëveshjet e deritashme

përfshijnë edhe atë për themelimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë, e cila është arritur në vitin 2013, por nuk është zbatuar kurrë.

Pas takimit, kryeministri Albin Kurti konfirmoi se palët kanë rënë dakord për përmbajtjen e propozimit evropian. "Ishte konfirmim që propozimi evropian është i pranueshëm dhe i pandryshueshëm. Ecja përpara do të jetë për planin e zbatimit. Jemi në një rrugë të mbarë dhe njëkahëshe të normalizimit të marrëdhënieve. Është marrëveshje e simetrisë, e fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimit në të ardhmen. Unë nuk kam nënshkruar, sepse pala tjetër nuk ishte e gatshme për të nënshkruar. Unë mendoj se është dëm që nuk është nënshkruar sonte, meqenëse u pajtuam", ka thënë ai.

Sa i përket gatishmërisë së tij për të zbatuar Marrëveshjen për Asociacionin e komunave me shumicë serbe, Kurti tha se për këtë ka folur më herët. "Ai është neni 10, është fjalia e fundit e praktikisht nenit të fundit dhe për këtë gjë tash jam përgjigjur", ka pohuar Kurti për gazetarët në Bruksel.

Vuçiq, në anën tjetër, tha se takimi me Kurtin ka qenë "i

vështirë". Ai tha se nuk u fol për miratimin ose mosmiratimin e propozimit të BE-së, por "për krijimin e planit të zbatimit". "Unë pres ta shoh planin e zbatimit, para së gjithash planin e zbatimit të obligimeve të mëparshme", tha ai, duke shtuar se ende duhet të punohet në udhërrëfyes. "Mendoj se është e rëndësishme që deklarata e BE-së të përfshijë domosdoshmërinë e zbatimit të të gjitha marrëveshjeve të mëparshme. Unë, natyrisht, insistova në Asociacionin e komunave me shumicë serbe", ka thënë Vuçiq.

PDK-ja: Kosova humbi njohjen dhe fitoi asociacionin

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka reaguar pas pajtimit në Bruksel mes Kurtit e Vuçiqit për zbatimin e të gjitha marrëveshjeve në dialog përmes planit franko-gjerman. "Ajo që kishim paralajmëruar edhe ndodhi. Kushtet dhe qëndrimet u shkrinë para interesave personale dhe ambicieve për pushtet të kryeministrit Kurti. Kosova humbi njohjen dhe fitoi asociacionin. Duhet thënë zëshëm dhe qartë: tashmë është

edhe zyrtarisht evidente se propozimi evropian nuk parasheh njohjen e ndërsjellë, si kriter kryesor për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe hapjen e perspektivës evropiane për shtetit tonë", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Sipas tij, aty nuk flitet për njohjen nga pesë vendet mos-njohëse të BE-së, nuk flitet për hapjen e rrugës drejt anëtarësimit në NATO, as për marrjen e statusit kandidat për anëtarësim në BE. "Për dy vjet me radhë, ne e kemi mbështetur Kryeministrin Kurti në raport me Serbinë. E kemi inkurajuar që të koordinohet me aleatët tanë ndërkombëtarë dhe i kemi ofruar edhe propozime konkrete në lidhje me marrëveshjen finale me njohjen e ndërsjellë në qendër. Duke e injoruar çdo ndihmë e këshillë që ka ardhur nga ne, kokë në vete dhe në kundërshtim me interesat afatgjatë të Republikës së Kosovës, kryeministri Kurti, përmes veprimeve dhe politikave të gabuara, degradoi pakthyeshëm procesin e dialogut. Rrjedhimisht, ai mundësoi heqjen e marrëveshjes finale me njohjen e ndërsjellë në qendër dhe i solli vendit një marrëveshje të

PSD-ja me aksion para objektit të qeverisë: Tension për Asociacion

Prishtinë, 27 shkurt - Partia Socialdemokrate (PSD) ka mbajtur të hënën aksion simbolik në ditën kur po mbahej takimi Kurti - Vuçiq në Bruksel.

Në objektin e Qeverisë së Kosovës, aktivistët e PSD-së kanë vendosur një baner ku shkruan "Tension për Asociacion", teksa në fotografi shihen kryeministri Kurti e presidenti Vuçiq përballë njëri-tjetrit me dorëza boksi, ndërsa në fund të tavolinës shihen duke i shtrënguar duart.

Kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, ka thënë se kjo karikaturë është ilustrimi pasqyruar i procesit negociator Kosovë-Serbi. "Për gjatë gjithë kësaj kohe është prodhuar tension për të kamufluuar koncesionin e madh që po del të jetë Asociacioni. Nga marrëveshje me njohjen në qendër tek Asociacioni në qendër të marrëveshjes. Ky është dëmi i madh, koncesioni i

madh, të cilin Kurti e ka bërë në kurriz të Republikës së Kosovës. Kjo marrëveshje, me planin e zbatimit tek i cili parashihen afatet kohore implementuese, jetëson Asociacionin si entitet të ri juridik, politik e të sigurisë. Entitet paralel karshi nivelit qendror të pushtetit", ka thënë Molliqaj.

Ai ka shtuar se Asociacioni është garanci e ndarjes etnike dhe i prishjes së karakterit unitar të shtetit të Kosovës. "Mbi të gjitha, Asociacioni po vjen përbrenda një marrëveshjeje tek e cila nuk parashihet njohja reciproke e cila do të garantonte, njëherë e përgjithmonë, paqe në mes të dy vendeve. Kurti nuk e ka legjitimitetin që të nënshkruajë marrëveshje që garanton themelimin e Asociacionit. Ky kryeministër duhet të jep dorëheqje qysh sot. Kosovës i nevojitet legjitimim i ri politik, si mundësi për shtetin e shoqërinë, si horizont për një marrëdhënie të re në mes të Kosovës dhe



Serbisë që garanton paqen e sjell njohjen reciproke", është shprehur Molliqaj, duke shtuar

se rruga në të cilën është futur Kurti është edhe e rrezikshme edhe e dëmshme. "Nga sot fillon

aktiviteti ynë në kundërshtimin e fuqishëm të kësaj rruge", ka deklaruar Molliqaj.

Limaj flet për mundësinë e rikthimit në PDK

Prishtinë, 27 shkurt - Kryetari i Nisma Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka shprehur mundësinë e ribashkimit me Partinë Demokratike të Kosovës (PDK). Kjo gjë, sipas tij, po bëhet për shkak "se vendi ka marrë drejtimin e gabuar".

Në një intervistë për "Ekonomia Online", Limaj ka thënë se situata aktuale ia ka detyruar që ta bëjnë një front të përbashkët opozitar. "Unë kam miq shumë dhe përditë takohem me njerëz. Kemi një histori të përbashkët, kemi shumë gjëra të përbashkëta, bile e kemi një pjesë të identitetit tonë politiko-historik, sidomos në luftë dhe pas luftës, prandaj nuk janë të



pazakonta këto takime. Ajo që mund të them për ju është se

kemi dalë me një ide për gjendjen çfarë është sot, ka

nevojë për një front të përbashkët, në bashkimin e forcës. Jam i interesuar t'i bashkojë forcat edhe me individë edhe me qytetarë, pra me ata që janë të brengosur në rrugën në të cilën është vendi, kursin cilin e ka kjo qeveri, me një frymë që ka përvojë brenda dhe e cila ka energjinë e re. Prandaj, interesimi im është që t'i bashkojmë forcat për të pasur një opozitë të fuqishme", ka thënë Limaj, teksa shton se detajet e frontit opozitar do të bëhen me dije më vonë. "Formula sesi vijmë deri te një bashkim, atëherë mbetet për t'u diskutuar", ka pohuar lideri i Nismës.

Limaj ka folur edhe për

kundërshtitë që ka brenda PDK-së për rikthimin e tij. Ai thotë se "njerëzit që mendojnë dhe u rrah zemra në një vend, duhet të bashkohen". "Mendoj që këta njerëz që mendojnë dhe u rrah zemra në një vend duhet të bashkohen, pra ta gjejnë një rrugë të bashkëpunimit. Formula sesi vjen deri aty, ia lëmë kohës, por një fillim i bashkëpunimit duhet të jetë. Kush nuk e sheh të nevojshme këtë ribashkim, atëherë është vendim i tyre. Besojmë se koha po e kërkon një rifuqizim sepse zhvillimet e deritanishme po ta imponojnë dhe po tregojnë se vendi e ka marrë drejtimin e gabuar", ka thënë Limaj.

përkohshme me asociacionin në qendër", ka theksuar Krasniqi, duke shtuar se krahas rritjes enorme të emigrimit si pasojë e keqkëqerjes, kryeministri Kurti sonte tkurri edhe sovranitetin e shtetit tonë. "Prandaj, 27 shkurti i vitit 2023, për Kosovën, me kryeministër Albin Kurtin, shënon një mundësi të humbur për shtetin tonë që ta përmbyllë përgjithmonë konfliktin e ngrirë me Serbinë", ka thënë lideri i PDK-së, Memli Krasniqi.

LDK-ja: Kurti e menaxhoi gabimisht dialogun, marrëveshja me asociacion dhe pa njohje

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka reaguar pasi kryeministri Albin Kurti u pajtua në Bruksel me propozimin evropian mbi normalizimin e

marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Nga deklarimi i kryeministrit mbi këtë marrëveshje tashmë të dakorduar, por ende të paprezentuar në Kuvendin e Kosovës, u vërtetuan brengat e LDK-së, të bëra tashmë publike. Kjo marrëveshje nuk është finale dhe nuk e përmban njohjen e ndërsjellë. Për më tepër ajo mban ambiguitet interpretues mbi statusin politik të dy shteteve. Gjithçka përveç njohjes - ishte qëllimi i Serbisë. Gjithçka përveç njohjes ka kjo marrëveshje sot, tashmë e pranuar nga palët", ka njoftuar LDK-ja.

Sipas LDK-së, dokumenti i pranuar po ashtu parashihet implementimin e të gjitha marrëveshjeve paraprake përfshirë dhe Asociacionin si dhe statusin e veçantë për Kishën Ortodokse Serbe. "Kryeministrit i ka mbetur



vetëm ta dakordojë datën e themelimit të Asociacionit, meqë ai, me pranimin e zbatimit të marrëveshjeve paraprake, ka pranuar që ta themelojë atë. LDK konsideron se menaxhimi tërësisht i gabuar i procesit të dialogut nga kryeministri i Kosovës përgjatë dy viteve të fundit, ka zhvendosur procesin e dialogut

nga një marrëveshje përfundimtare e ligjërish të obligueshme në një marrëveshje bazë, pa njohje në të dhe me vazhdimësi dialoguese për vitet e ardhshme. Përfundimi në mes të zgjedhjes së një marrëveshje të tillë dhe izolimit eventual të Kosovës janë përgjegjësi e këtij kryeministri", është thënë në njoftimin e LDK-së.

Haradinaj: Pajtimi për ta pranuar propozimin evropian, një e arritur e madhe

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka theksuar se pajtimi për ta pranuar propozimin evropian për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi, është një e arritur e madhe. "Marrëveshja është pranim faktik i pavarësisë së Kosovës, e cila i rikthehet normalitetit politik e të sigurisë, perspektivës integruuese euro-atlantike e njohjeve të reja. Po aq e rëndësishme mbetet edhe faza vijuese e bisedimeve për çështjet tjera të hapura, për të cilat dua të besoj se do të gjenden zgjidhjet më të mira, me çka do të përmbylej edhe kapitulli i njohjes 'de jure' midis Kosovës dhe Serbisë", ka deklaruar Haradinaj.

Propozimi franko-gjerman me në qendër njohjen formale të... Bangladeshit



Behxhet Sh.
SHALA -BAJGORA

Pafytyrësia si vlerë morale, nënshtrimi si detyrë "kombëtare": Kosova është në një udhëkryq ku të gjitha rrugët çojnë drejt një rilidhje me Serbinë, konfederalizim apo federalizim është çështje teknike. Ndërkombëtarët nuk duan ta prenë kërthizën me Serbinë ndërsa politikanët e Kosovës luftën kryesore e bëjnë midis vetes. Deri në asgjësim. Sakrifikuesit kryesorë që e sollën këtë liri kështu si e kemi dhe këtë shtet ashtu si është me një pavarësi, integritet territorial dhe sovranitet sui generis i dërguan në Hagë kurse vlerat e përjetshme kombëtar dhe njerëzore siç ishin Frymëzimi për Liri, Pavarësi dhe Bashkim Kombëtar, Baca Adem Demaçi dhe Adem Jashari përkujtohen në data të caktuara, kryesisht për përfitime politike dhe elektorale. Nuk ka shtresim politik që aq shumë i ka sulmuar çlirimtarët, sakrifikuesit dhe ndërtuesit e shtetit se që e bënë pushteti aktual që, në mesin e vet ka aq shumë mohues të kombit dhe lirisë, vazhdues biologjikë dhe politikë të ish-shtypësve dhe torturuesve tanë, hetues, dhunues dhe vrasës të çdo përpjekje që e bënë breza e breza atdhetarë, që nga Rilindja e Kombit, deri më sot. Pas përfundimit të luftës, koha dhe proceset politike kërkonin personat që ishin në skenën politike. Ata bënë, në rrethana të një mbikëqyrjeje të rreptë ndërkombëtare atë që kishin mundësi, duke bërë edhe gabime. E bënë, pa asnjë borxh të jashtëm infrastrukturën rrugore, ndërtuan shkolla dhe objekte tjera sikur që siguruan një standard që

përafërsisht plotësonte nevojat e qytetarëve. Miratuan ligje për përfituesit socialë, veteranët e luftës, viktimat e dhunës seksuale, për të pagjeturit sikur që kompensuan ish të burgosurit politikë. E ndërtuan një themel për shtet me shpallje të pavarësisë duke integruar pakicat, diku plotësisht e diku pjesërisht. Në të njëjtën kohë në skenë u paraqit një shtresim politik, fillimisht si KAN, pastaj Lëvizje Vetëvendosje për t'u shndërruar në parti VV, e udhëhequr nga Albin Kurti, një kohë rob luftime në Serbi. Me t'u liruuar, Albin Kurti e kishte përkrahjen në çdo aspekt nga Adem Demaçi dhe Behxhet Shala të cilët sinqerisht besuan se Albini është njeri i ndryshimeve, kombëtarisht i paluhatshëm, trim i vendosur, me parime politike të padiskutueshme, materialisht i pakorruptuar, i vendosur për bashkim kombëtar, në fushën e negociimit i pakompromis dhe se, në asnjë rrethanë nuk do t'i binte bakllavasë. Sa idealistë, shkurtpamës dhe budallenj që ishim. Baca Adem e kuptoi shumë më herët duke i ndarë rrugët politike me Albinin, unë edhe për një kohë isha në rolin e budallait. Në atë kohë Albin Kurti mohonte çdo të arritur dhe tash ndërtuesit e shtetit i quan "shkatërrues të shtetit" duke i shfrytëzuar të gjitha të mirat e këtij shteti që ia lanë "shkatërruesit e shtetit" në një shtet që e ka mohuar deri në kohën sa i hypi sipër.

Po ç'po bën Albini për këtë shtet: Si pika motivuese për ta lëvizur ortekun e 51 për qind të votave të fituara, Albini e kishte bashkimin kombëtar, refuzimin e Zajebnicës, luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar, kompensimin e dëmeve të krimeve të luftës nga Serbia, çështja e të pagjeturve, kushtëzimi i çdo takimi me Vuçiqin me kërkimfalje, integritimin e veriut dhe shumë përralla të tjera. Që dolën të jenë mashtrime të paskrupullta, mjet për t'u ngjitur në pushtet, për pushtet absolut, tash gjysmëdiktatorial, me qëllim të shndërrohet në diktaturë.

Kundërshtarët i dërguan në Burgun Racist të Hagës duke duartrokatur çdo dënim që i mbanë larg Kosovës dhe pushtetit të tij mashtrues, primitiv dhe të papërgjegjshëm. Asnjë premtim nuk e përmbushi deri më tani, përkundrazi. Më herët për pengjet e Hagës thoshte se, edhe nëse e kanë shtetin, e shkatërrojnë atë kurse edhe nëse e kanë pavarësinë, e humbin atë. Sa mirë dhe saktë e ka përshkruar gjendjen e sotme ku protagonistin kryesor është pikërisht vetë ai, dhunuesi i çdo vlere demokratike dhe i vet shtetit, Albin Kurti. Qeveritë e kaluara e lanë trashëgimi Zajebnicën kurse Albin Kurti, si vlerë të shtuar e ka, si ai maniaku në Mal të Zi që e flet një shqipe të bausthellës, fuqizimin e Kishës Ortodokse të Serbisë në Kosovë, si Zajebnicë në vete në kryeqytet Manastirin e Deçanit. Me pranimin e propozimit franko-gjerman, me Zajebnicën politike serbe dhe Zajebnicën ortodokse serbe në qendër, e konservon Kosovën turshi, si lakrën e Bledi Manes për disa periudha dhjetëvjetëshe, pa një dinamikë dhe afat të qartë se kur dhe si do të përfundojë. Serbia dhe Aleksandër Vuçiq, as po ta zinin peshkun e artë nuk do të fitonin në shumë se sa që pi ua mundëson propozimi franko-gjerman dhe Albin Kurti. Serbia nuk po bënë asnjë kompromis dhe asnjë sakrificë, palë e lagur pi dalim ne. Në vend të insistimit për njohje de jure nga Serbia, Albin Kurti po shet përralla se ky propozim në qendër e ka njohjen de fakto. E çka qenka njohja de fakto? Është përpjekje me la m.. me shurrë, si na mëson urtia popullore. Kompromise të mëdha dhe jonormale po i bënë Kosova dhe jo Serbia. Nëse Albin Kurti rrethohet nga leshko legjendarë, që i ka zgjedhur për ta mbajtur pushtetin dhe për ta kalkuluar çdo propozim përmes kushtëzimit të këtyre mjeranëve, së paku të bëhet korrekt me vlerat dhe thesarin kombëtar siç janë Mehmet Dragoviçi Kraja, Martin Berishaj, Ton Qyrra, Rim Shurraku dhe të tjerët që, pa dyshim do t'i

përmend më vonë. U lajmërua me këshilla shumë praktike dhe të domosdoshme, patrioti i shquar jugosllav, që nga koha e Titos, Zem Vleshi. Nuk e di nëse është gjallë Buba Morina e cila, nëse është gjallë mund të na ofrojë ndonjë testament politik të shoqit të saj, Rrahman Morina që ishte arkitekti i themelimit të LDK-së dhe spiritus movens politik i mendermethënë kryetarit aktual të ASHAK-ut, Mehmetkrajëlazanskit. Testamenti i mundshëm politik, në rrethanat aktuale do të kishte vlerën e "Gurit Filozofik" për kryeministrin dhe kotillën e tij politike që po e ngrënë në qiell propozimin franko-gjerman duke kërkuar dhe gjetur arsytim për çdo pikë. Në momentin kur i hynë arsytimit për gjëra që nuk arsyetohen dhe për të cilat është derdhur gjaku, kanë mbetur fëmijët jetimë, pa asnjë dyshim bëheni familjarë kombëtar dhe politikë i Rrahman Morinës, për fillim. Si erdhi propozimi franko-gjerman: Këtë propozim nuk ua solla unë e as nuk e gjeta në mesin tuaj por ua solli "Karll Bildti" nga Gjylekari, i deleguari special i Albin Kurtit, Besnik Bislimi. Si një urith, thuaja gjatë dy vjetëve, në takime të fshehta dhe publike, në nëntokë dhe mbitokë, me Lajçak, Borrellin, Petkoviçin dhe iqët tjerë nga Kosova dhe Serbia, gatoi një "srpski slavski kollaq" "kulaç serb i Pashkëve" që tash po na serviret si propozim franko-gjerman. Në fshehtësinë dhe terrin të cilin nuk mund ta gjeni as në Ferrin e Dantes, gjoja për të mos dëmtuar negociatat, ky person pa asnjë të kaluar politike dhe kombëtare e pranon një ofertë që e kthen Kosovën në pikën zero, e futë në një proces të ngrirjes së thellë duke vënë në një gjendje të gumit të thellë, si hibernacioni te arinjte polarë. BB (Big Brother i Ekipit Negociator) fillimisht deklaronte se propozimi franko-gjerman është interes i Serbisë, tash i aziluar si mizë kali në lokacionin me temperaturë optimale në një pjesë të trupit të KM ku edhe mendon se ka siguri, thotë të pyetet Shefi për këtë. Sa i mjerë dhe sa i

pamoralshëm, pa dinjitet dhe pa integritet.

Çka do të bëhet më 27 shkurt 2023 në Bruksel: Pa asnjë dyshim se Kurti do ta nënshkruajë pranimin e këtij propozimi dhe se do ta zbatojë çdo pikë dhe presje që i mundëson jetëgjatësi në pushtet. Zajebnica është punë e kryer dhe atë nuk do ra udhëheqin as Nenad Rashiçi e as Llepa Rada por ata që caktohen nga Aleksandër Vuçiq, Rashiçi dhe Rada do të mbahen mend si "serbët e Kurtit" dhe nuk kanë mandat ta përfaqësojnë askënd, madje as njëri - tjetrin. Janë si luleborët, kanë afat të caktuar me një dallim se këta realisht nuk janë çelur fare, nuk kanë petale e lëre më erë. Me një fjalë, duke kundërshtuar çdo gjë më parë tani do të pranojnë çdo gjë. Pa asnjë kriter dhe pa asnjë moral, në emër të parimeve të larta, ruajtjes së miqësisë me Borrellin dhe Lajçakun dhe me shpresë se do të lavdërohen nga Eskobar, Chollet dhe, si kulm ndonjë thirrje telefonike nga Blinken. Vullkanike do të ishte një foto për moto me Bajdenin. Edhe e meritojnë, Albin Kurti, si kryeministër i Ukrainës, me orar të plotë dhe i Kosovës, kohë pas kohe. E shoqëruar me komandanten e përgjithshme të Ushtrisë së Ukrainës e cila, si adhuruese e flaktë e muzikës së Richard Wagner, askund nuk po iu lë vend paramilitarëve të Wagnerit, në Ukrainë dhe në Kosove. Opozita duhet ta ndryshojë emërtimin duke u riemëruar si: "mrizues të situatës", pa vullnet, guxim dhe dëshirë ta ndryshojnë atë. Ngadalë, nëse nuk do të zgjohen nga rënia e presionit, pashmangshëm do të bëhen ushtarë të Besnik Gjylekares. Vdekja është më e lehtë në këtë rast. Mos pritni asgjë nga e hëna, teshat janë të prera, koha po përmirësohet prandaj nuk kemi nevojë ta ruajmë fytyrën kurse prapancën më shumë e kemi pasur të shpluar se të mbuluar. Nuk e kemi asnjë problem që për një interes apo copë pushteti, t'i lëshojmë brekët.

ZPS-ja kërkon t'u vazhdohet masa e paraburgimit Krasniqit dhe Selimit

PRISHTINË, 27 SHKURT - Me anë të dy shkresave drejtuar trupit gjykues, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ka kërkuar që t'u vazhdohet masa e paraburgimit Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Në këto shkresa është thënë se gjyqtari i procedurës paraprake dhe Gjykata e Apelit kanë konstatuar në mënyrë të përsëritur se paraburgimi i tyre është i arsyetuar në baza të shumta, se asnjë kusht

tjetër përveç paraburgimit në objektet e paraburgimit të Dhomës së Specializuar të Kosovës nuk do të ishte i mjaftueshëm për t'i minimizuar rreziqet dhe se periudha e paraburgimit, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat përkatëse, është e arsyeshme, raporton "Betimi për Drejtësi". Sipas prokurorisë, që nga përcaktimi më i fundit i këtij paneli më 17 janar 2023 nuk ka pasur asnjë ndryshim në rrethanat që meritojnë të

devijojnë nga ai përcaktim. Më tutje, është thënë se në të vërtetë, transferimi i lëndës në Panel, caktimi i datës së gjykimit dhe zhvillime të tjera të rëndësishme që tregojnë përparim të qëndrueshëm dhe do t'u japin atyre qasje të mëtejshme në informacione në lidhje me dëshmitarët e ndjeshëm dhe rastin kundër tyre, mbështesin domosdoshmërinë dhe arsyeshmërinë e paraburgimit.



Haradinaj në Gjermani: Mërgimtarët janë pjesa jonë më me vlerë

PRISHTINË, 27 SHKURT - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, po qëndron në Gjermani. Ai ka zhvilluar takime me mërgimtarë. "Mërgimtarët janë pjesa jonë më me vlerë. Ata, edhe pse janë larg atdheut, arritën të gjejnë çdo herë mënyra që të punojnë dhe kontribuojnë për të. "Kisha kënaqësinë që në kuadër të takimeve me bashkatdhetarë në Gjermani, të takoj kryesinë e shkollës shqipe 'LAPSH', shkollë kjo e cila po bënë një punë mbresëlënëse në shërbim të komunitetit shqiptar në Nuremberg e rrethinë", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Ai e ka përgëzuar stafin drejtues të kësaj shkolle, prindërit dhe mësuesit, të cilët në mënyrë vullnetare po e mbajnë gjallë shkollën shqipe, me qëllim të ruajtjes së ruajtjes së vlerave dhe identitetit tonë kombëtar. "Po ashtu, në takim me Bashkësinë Islame Shqiptare "Bashkimi"

përjetova pritje të ngrohtë vëllazërore, me ç'rast me bashkatdhetarët pata rastin të bashkëbisedoj për tema të ndryshme. Imamit Segvani Asani dhe bashkëpunëtorëve i shpreha konsideratën dhe vlerësimin për punën dhe angazhimin në shërbim të mërgimtarëve tanë në Gjermani. Mërgata jonë kudo në botë është e organizuar në secilin segment të jetës ku përmes organizimeve të ndryshme dhe aktivitetit të tyre të rregullt, janë bërë model edhe për komunitetet tjera ku ata jetojnë", ka shkruar Haradinaj.

Ai gjatë qëndrimit në Gjermani ka parë nga afër suksesin që shqiptarët kanë arritur atje në shumë sfera. "Një pjesë e madhe e tyre tanimë zotërojnë biznese të suksesshme, të matshme dhe jo rrallë herë më të mëdha se ato vendore në shtetin ku jetojnë e veprojnë. Kompania 'Baliu Trans GmbH & Co.KG', themeluar dhe udhëhequr nga z. Bajram Baliu, e cila ka të punësuar mbi 200 punëtorë, me profesionalizëm



dhe korrektësi ka arritur që të jetë njëra ndër kompanitë më serioze në fushën e transportit dhe logjistikës. Po ashtu, me bashkëpunëtorë vizitua

ndërmarrësin e suksesshëm z. Selim Ukaj, me ç'rast u njoftuam rreth veprimtarisë së kompanisë së tij 'ADLER Haustechnik GmbH'. Krenar me punën dhe

sukseset e bashkatdhetarëve tanë gjithandej nëpër botë. Arritjet e tyre janë arritje edhe të Kosovës", ka theksuar lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj.

Dy të vdekur nga Covidi, IKShPK-ja bën apel: Bartni maskat në ambiente të mbyllura

EPOKA E RE

Faton DËRMAJKU

Prishtinë, 27 shkurt - Dy persona kanë ndërruar jetë në 24 orët e fundit në Kosovë si pasojë e infektimit me Covid-19 ka bërë me dije Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK), ndërkohë që u ka bërë thirrje qytetarëve t'i bartin maskat në ambiente të mbyllura.

Duke bërë thirrje për kujdes të shtuar ndaj Covid-19, IKShPK-ja ka potencuar rëndësinë e vaksinimit kundër virusit. "Ju lutemi bartni maskat në ambiente të mbyllura dhe vaksinohuni! Ju lutemi për kujdes të shtuar ndaj Covid-19! Në vende të ndryshme të botës po regjistrohen raste të shumta të Covid-19, sepse pandemia akoma nuk ka mbaruar. Covid-19 në Kosovë shënon trend të rritjes së rasteve të reja. Fatkeqësisht sot kemi të regjistruar dy raste fatale të cilët kishin sëmundje shoqëruese",



thuhet në njoftimin e IKShPK-së. IKShPK-ja ka treguar edhe simptomat të cilat duhet të

shërbejnë si arsye për testim. "IKShPK është duke vazhduar pandërprerë testimin dhe

gjurmimin e të gjitha rasteve, kontakteve të rasteve në komunitet dhe diagnostikimin

laboratorik andaj të gjithë personat me kokëdhembje, kollitje, dhembje fyti, vështirësi në frymëmarrje, rrjedhje hundësh, temperaturë, plogështi, humbje e shijes, rekomandohen të testohen", ka rekomanduar IKShPK-ja.

Me qëllim të përforcimit të imunitetit dhe parandalimit të rasteve të reja dhe formave të rënda të sëmundjes, Instituti këshillon qytetarët që të vaksinohen.

"MSh-ja dhe IKShPK-ja rekomandojnë qytetarët që rritja e rasteve me Covid-19 kërkon edhe masa parandaluese andaj duhet të të jenë të kujdesshëm në zbatimin e masave preventive kundër sëmundjeve ngjitëse duke zbatuar vendimet e Qeverisë, duke bartur maska në të gjitha ambientet e mbyllura, distancë, higjienë, dezinfektues për duar në të gjitha institucionet publike e private dhe të vaksinohen kundër Covid-19", ka apeluar IKShPK-ja.

Nitaj: Një pjesë e spektrit politik i fërkon duart për dështimin e Kurtit

PRISHTINË, 27 SHKURT - Sekretari i përgjithshëm i AAK-së, Muharrem Nitaj, ka thënë se e kupton që një pjesë e spektrit politik i fërkon duart për dështimin e Albin Kurtit në dialog. "E kuptoj që një pjesë e spektrit politik në Kosovë i fërkojnë duart për dështimin e Albin Kurtit dhe e presin me padurim rënien e tij.

Ndoshta ai edhe i ka plotësuar të gjitha kushtet që të mos jetë më kryeministër i vendit, por dështimi i tij në arritjen e marrëveshjes me Serbinë, nuk do të ishte dështim vetëm i tij, por dështim edhe i Kosovës", ka shkruar Nitaj në "Facebook".

Ai ka theksuar se zërat kundër propozimit franko-

gjerman nuk e ndihmojnë as Kosovën e as Albin Kurtin. "Është mirë që këtë ta kuptojnë së pari militantët e tij, më pastaj edhe kundërshtarët. Në politikë ndonjëherë është e nevojshme ta tradhtosh ose vendin ose elektoratin. De Gol ka thënë se do ta preferonte tradhtinë ndaj elektoratit", ka shkruar Nitaj.



Grevat e punëtorëve anulojnë qindra fluturime në aeroportet gjermane



KOLN, 27 SHKURT - Pothuajse të gjitha fluturimet në Aeroportin Koln-Bon të Gjermanisë dhe shumica në Dyseldorf janë anuluar ose devijuar për shkak të grevave. Largimet po prekin gjithashtu transportin lokal, objektet e kujdesit ditor dhe administratën lokale në rajonin më të populluar të Gjermanisë. Në Aeroportin Këln-Bon grevat filluan të dielën në mbrëmje. Të hënën, të gjitha, me përjashtim të dy prej 136 fluturimeve të planifikuara të ditës, pritet të realizohen. Në Dyseldorf vetëm 89 nga 330 fluturimet e planifikuara pritet të kryhen sipas planit, me shumicën e pjesës tjetër të

anuluar. Grevat në të dy aeroportet pritet të përfundojnë gjatë natës mes të hënës dhe të martës. Linja ajrore "Eurowings", një degë e "Lufthansa", thotë se "pret që operacionet e fluturimit të kthehen në normalitet që të martën". "Greva paralajmëruese" njëditore vjen mes bisedimeve të vështira për pagat për punonjësit e qeverive federale dhe komunale të Gjermanisë dhe për stafin e sigurisë së aeroportit. Lëvizjet e planifikuara të hënën gjithashtu ishin vendosur t'i prekin autobusët dhe tramvajet në pjesë të shtetit perëndimor të North Rhine-Westphalia si dhe qendrat e kujdesit ditor për

fëmijët dhe shërbime të tjera. Sindikatat po kërkojnë një rritje pagash prej 10.5-përqindësh. Punëdhënësit deri më tani kanë ofruar një rritje prej 5-përqindësh në dy faza dhe pagesa të njëhershme prej 2 500 eurosh për punonjësit - të cilat sindikatat e kanë refuzuar si të pamjaftueshme. Grevat paralajmëruese të organizuara nga sindikata Ver.di NRW çuan në anulimin e mijëra fluturimeve në shtatë aeroporte gjermane. "Lufthansa" u detyrua t'i anulojë të gjitha fluturimet nga Frankfurti dhe Munihi vetëm disa ditë pasi një dështim i IT-së shkaktoi ndërprerje të madhe për linjën ajrore.

Dogana e Kosovës autorizon kompaninë e tetë si operatore ekonomike

PRISHTINË 27 SHKURT - Dogana e Kosovës ka avancuar më tej me lehtësira tregtare duke rritur numrin e Operatorëve të Autorizuar Ekonomikë (OAE). Në kuadër të kësaj, pas përmbushjes së kriterëve të parapara ligjore, drejtori i përgjithshëm i Doganës së Kosovës, Agron Llugaliu, me bashkëpunëtorë ka ndarë certifikatën e radhës për operatorët e autorizuar ekonomikë për kompaninë "Albi Commerce" Sh. P. K. - Prishtinë. Kjo kompani merret me

importin dhe distribuimin e produkteve ndërkombëtare në vendin tonë. Me këtë rast, kompania i ka përmbushur standardet më të larta që të përfitojë nga thjeshtëzimet e ndryshme të parashikuara nga legjislacioni doganor (OAE-D) në kuadër të këtij programi dhe konsiderohet si një partner e besueshme në procedura doganore. Dogana e Kosovës ka theksuar se është e përkushtuar t'u krijojë lehtësira në procedurë subjekteve të tilla që plotësojnë kriteret e parapara

me dispozitat ligjore në fuqi. Një OAE mund të përkufizohet si një operator ekonomik i cili konsiderohet i besueshëm, në kontekstin e procedurave doganore të tij dhe për këtë arsye ka të drejtë të gëzojë përfitime të caktuara në të gjithë Kosovën. Programi OAE-s është i hapur për të gjithë operatorët ekonomikë, duke përfshirë ndërmarrjet e vogla, të mesme dhe ndërmarrjet e mëdha dhe pa marrë parasysh rolin e tyre në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit.



Ministri i Bujqësisë mori pjesë në ceremoninë e qethjes së deleve



PRIZREN, 27 SHKURT - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka marrë pjesë në ceremoninë e qethjes së deleve të fermerit Berat Muja në Zhur të Prizrenit. Muja mbarështron 1 400 krerë dele e qengja, ndërsa thotë se qumështin dhe mishin e deleve e plasojnë në tregun vendor, sidomos djathin e Sharrit, si një nga produktet më të kërkuara në treg.

Berat Muja, pos që merret me blegtorinë, ai mbjell edhe rreth 22 hektarë grurë dhe për delet e tij përkujdeset në rreth 30 hektarë kullosa. Duke parë nga afër punën që po zhvillohet në fermë, si dhe përgatitjen për ceremoninë e qethjes së deleve, ministri Peci ka thënë se fermerët të përkushtuar si Muja janë motivues për punën institucionale në aspekt të përkrahjes financiare përmes

subvencioneve dhe granteve. "Përmes Programit për Zhvillim Rural - Grante 2022, si risi kemi përkrahur edhe përpunimin e leshit të deles, si fazë përmbyllëse e zinxhirit mbarështues. Njëherësh këtë vit, risi dhe në fokus do ta kemi rritjen e Fondit Blegtoral të Kosovës, duke parë potencialin që blegtoria ka për zhvillim ekonomik të vendit dhe ekonomi rrethore", u shpreh ministri Peci.

DHTIK-ja dhe Ambasada e Kosovës bashkëpunojnë në fushën e ekonomisë

PRISHTINË, 27 SHKURT - Rritja e komunikimit dhe bashkëpunimit në mes të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës (DHTIK) dhe Ambasadës së Kosovës në Vjenë ishte temë kryesore e takimit në mes të kryetarit të DHTIK-së, Skënder Krasniqi dhe

ambasadorit Lulzim Pllana. Me këtë rast Pllana e njoftoi Krasniqin për punën e Ambasadës së Kosovës dhe kontributin që është duke dhënë në lidhjen e bizneseve që janë të interesuara të investojnë në Kosovë, por

edhe ata që janë të interesuar të eksportojnë produkte në Austri. Po ashtu, u diskutua edhe shqyrtimi i mundësive për organizimin e shumë aktiviteteve të përbashkëta në mes të DHTIK-së dhe Ambasadës së Kosovës në Austri.



Interceptohen tetë sinjale të reja nga hapësira: A janë jashtëtokësorë?

Tetë sinjale radio misterioze janë zbuluar gjatë vëzhgimit të 820 yjeve, në një pjesë të hapësirës midis 30 dhe 90 vite dritë larg.



Ka ndodhur disa herë që astronomët të kenë hasur në sinjale radio që vërtet duken se prodhoheshin nga alienë inteligjentë. Gjithmonë, duke i analizuar me kujdes, u konstatua se ato kishin një burim natyror. Tani, falë një algoritmi të ri të trajnuar nga inteligjenca artificiale, janë kapur 8 sinjale me interes të madh. A kemi gjetur një sistem të ri për të thjeshtuar kërkimin e mesazheve aliene?

Zbulimi u bë nga ekspertë, të udhëhequr nga Peter Ma i Universitetit të Torontos, të cilët po përdornin algoritmin për të vëzhguar 820 yje në një zonë të hapësirës që më parë mendohej se nuk kishte ndonjë aktivitet të mundshëm jashtëtokësor. Puna e tyre, e botuar në Nature Astronomy, u krye në bashkëpunim me SETI

(organizata private shkencore, qëllimi i së cilës është kërkimi i jetës inteligjente jashtëtokësore përmes programeve kërkimore ndërkombëtare për sinjale të mundshme të prodhuara nga alienët inteligjentë), projektin Breakthrough Listen dhe institucione të tjera kërkimore në fushën e kërkimit të radioastronomisë, për të gjetur mesazhe jashtëtokësore.

GJILPËRA NË KASHTË

Pjesa e qiellit i analizuar nga Ma dhe kolegët tashmë ishte studiuar më parë falë teleskopit Robert Byrd Green Bank në Virxhinia Perëndimore (SHBA), pra radioteleskopi më i madh plotësisht i drejtuar në botë (100 m diametër): megjithatë duke përdorur metodologjinë e vjetër,

por nuk u evidentua asnjë shenjë me rëndësi të veçantë.

Steve Croft, një nga drejtuesit e projektit Breakthrough Listen të Teleskopit Green Bank, shpjegoi: “Problemi kryesor është të shikojmë nëpër kashtën e madhe të yjeve dhe sinjaleve të radios që na rrethojnë, për të gjetur gjilpërën që mund të jetë një transmetim nga një botë aliene. Fatkeqësisht, shumica dërrmuese e sinjaleve të marra nga teleskopët tanë vijnë nga teknologjia jonë: satelitët GPS, telefonat celularë dhe të ngjashme. Algoritmi i Peter Ma ofron një mënyrë më efektive për të filtruar kashtën.”

DËGJOJMË MË MIRË

Si duhet të jenë sinjalet për të qenë jashtëtokësorë? Së pari, ato duhet të jenë me brez të ngushtë, pasi

ato të shkaktuara nga fenomenet tokësore priren të jenë me brez të gjerë. Ata gjithashtu duhet të kenë një “zhvendosje të pikut” në lidhje me lëvizjen rrotulluese të Tokës, të cilën sinjalet tokësore nuk e kanë. Dhe së fundi, ato shfaqen vetëm kur drejtoni antenën në një vend të caktuar, ndërsa sinjalet tokësore vijnë gjithmonë.


“Sinjalet janë të pranishme kur njeriu tregon yllin dhe mungojnë kur «shikon larg»; në krahasim me ndërhyrjet lokale, e cila zakonisht është gjithmonë e pranishme,” shpjegoi Croft. “Në total, ne kërkuam 150 terabajt të dhëna të mbledhura nga 820 yje aty pranë. Ky është i njëjti grup të dhënash i studiuar në 2017 me teknikat klasike: në atë kohë arritëm në përfundimin se nuk kishte sinjale interesante. Tani po e çojmë këtë përpjekje kërkimi në një milion

yje, falë teleskopit MeerKAT.”

ASNJË SIGURI

Këto tetë sinjale që duket se vijnë nga drejtimi i pesë yjeve në një hapësirë që përmban 820 yje, të cilët ndodhen midis 30 dhe 90 vite dritë larg, nuk janë përsëritur: kjo nuk na lejon të themi me siguri absolute se janë sinjale inteligjente.

Astronomët duhet t'i luajnë edhe një herë për të përjashtuar 100 për qind se nuk është ndërhyrje në Tokë, por kjo tregon se sa jetik është algoritmi i ri për të gjetur qytetërimet aliene. Tani gjithçka që duhet të bëjmë është të presim: nëse ata janë atje dhe na dërgojnë sinjale, së shpejti do të jemi në gjendje t'i marrim. / focus – bota.al



Veton Zymberi, redaktor i sportit

FBK-ja organizon FIBA 3x3 U23 Nations League

PRISHTINË, 27 SHKURT - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) ka fituar të drejtën për të organizuar një tjetër ngjarje madhore. Kësaj radhe FBK do të organizojë FIBA 3x3 U23 Nations League. Kjo është hera e parë që në vendin tonë organizohet një ngjarje e tillë, kurse Kosova ka qenë mikpritëse e FIBA Kampionateve Evropiane, Divizioni B dhe C, si dhe Challenger.

FIBA 3x3 Nations League është një garë kombëtare e FIBA 3x3 për meshkuj dhe femra nën moshën 23 vjeç, që ka filluar të organizohet në vitin 2017. Kjo garë ofron një mundësi të mirë për talentet e së ardhmes që t'i përmirësojnë aftësitë e tyre në përgatitjen për kategorinë seniorë dhe garat elitare siç janë FIBA 3x3 Kupa e Botës, Lojërat Olimpikë etj.

Federatat kombëtare që marrin pjesë në këtë program duhet të regjistrojnë 1 ekip të meshkujve dhe 1 të femrave në çdo "stacion" të FIBA 3x3 U23 Nations League. Federata e Basketbollit e Kosovës për herë të parë do të marrë pjesë në këtë garë, por edhe do ta bëjë organizimin e një "stacioni" të



Nations League në vendin tonë me 10-12 korrik 2023. Në FIBA 3x3 Nations League marrin pjesë 12 ekipe (meshkuj/femra). FIBA 3x3

Nations League 2022 përmban një rekord me pjesëmarrje të 57 Federatave Kombëtare në këtë garë.

SHKURT

Cluji: Krasniqi kushton 5 milionë euro

Ylli i Ballkanit, Ermal Krasniqi, u transferua te Cluji në afatin kalimtar të janarit. Krasniqi, ashtu si me Ballkanin, edhe me skuadrën rumune është duke shkëlqyer. Interesim për anësin nga Malisheva kanë treguar disa skuadra italiane, përfshirë Torinin dhe Lazion, ndërsa Cluj e ka vendosur çmimin e kartonit të yllit të ri kosovar, të cilin e vlerëson 5 milionë euro. Kjo shumë konsiderohet mjaft e lartë, pasi klubi rumun e bleu Krasniqin nga Ballkani për 200 mijë euro.

Xhaka po negocion kontratën e re me Arsenalin

Mesfushori i Arsenalit, Granit Xhaka, ka negociuar një kontratë të re me klubin. Lajmi është dhënë nga "Football Insider". Në të njëjtën kohë, trajneri i Topçinjve, Mikel Arteta, tha ditë më parë se klubi ende nuk kishte negociuar me Granit Xhakën. Kontrata aktuale lidh Granit Xhakën me Arsenalin deri në mesin e vitit 2024. Mesfushori zviceran luan për klubin londinez që nga vera e vitit 2016. Që atëherë, Xhaka ka bërë 282 paraqitje për Topçinjtë, duke shënuar 18 gola dhe duke dhënë 27 asistime për shokët e skuadrës.

Lëndohet Lewandowski, në dyshim për 'El Clasicon'

Pas humbjes nga Almeria, Barcelona ka marrë edhe një lajm të keq. Bëhet fjalë për lëndimin e Robert Lewandowskit i cili pësoi një lëndim në gjurin e majtë në humbjen që pësoi skuadra e tij të dielën në La Liga. Mediet spanjolle njoftojnë se sulmuesi polak do të mungojë në ndeshjen e parë gjysmëfinale të Copa del Rey. Ish-futbollisti i Borussia Dortmundit dhe i Bayern Munchenit do të mungojë në dy duelet e ardhshme të Barçës, përfshirë këtu edhe "El Clasicon" e parë kundër Real Madridit. Por, veterani i sulmit pritet të jetë i gatshëm për ndeshjen e kampionatit me "Los Blancos" më 19 mars.

Messi, rekord të ri, 700 gola me klube

Lionel Messi vazhdon ta shkruajë emrin e tij në histori të futbollit. Për yllin argjentinas, ndeshja me Marseillen ishte speciale. Krahas fitores ndaj rivalit më të madh të Paris Saint-Germainit, shtatë herë fituesi i "Topit të Artë" e bëri edhe një arritje speciale. 35-vjeçari arriti në kuotën e 700 golave me klube, përfshirë këtu 672 me Barcelonën dhe 28 me PSG-në. Krejt këto, kampioni i freskët i botës i arriti në 840 ndeshje, respektivisht për 103 ndeshje më pak se rivali kryesor i tij, Cristiano Ronaldo, të cilit i ishin dashur 943 ndeshje për ta bërë këtë arritje. Më saktësisht, Messi e bëri këtë arritje të madhe për 17 vjet e 301 ditë që nga dita e parë kur kishte shënuar.

40 ditë paraburgim për futbollistin e Gjilanit

GJILAN, 27 SHKURT - Futbollisti i Gjilanit, Theolophilus Solomon, do të qëndrojë për 40 ditë në paraburgim. Ky është vendimi i Gjykatës Themelore të Gjilanit, e cila e ka aprovuar sot kërkesën e Prokurorisë Themelore të Gjilanit. Sulmuesi Solomon akuzohet për veprimin e bërë në kohën sa luante në Shqipëri, ku kishte shfaqur dhunë familjare para se të transferohej në Kosovë, ku fillimisht luajti me Ballkanin e tash me "Skifterat". Gjykata njofton se ekziston dyshimi se në vitin 2021 në Tiranë, tani i dënuari Th. S. (futbollist), në shtëpinë e tyre të përbashkët i ka shkaktuar lëndime trupore të dëmtuarës E. P., me çka ka kryer veprën penale "dhunë në familje" nga neni 130/A/1 i Kodit Penal të Shqipërisë, për të cilën veprë është gjykuar me 11 muaj e 6 ditë burgim. "Sipas vlerësimit të gjyqtarit, meqë i dyshuari mund të arratiset, i është caktuar masa e paraburgimit. I njëjti fillimisht është arratisur nga shteti ku e ka kryer veprën penale dhe se i njëjti pas arratisjes nga Shqipëria është vendosur në Kosovë, ku me datë 17



tetor 2022 ka marrë leje qëndrim me vendbanim në Prishtinë dhe nga shkresat e lëndës i njëjti ka shtetësi të Nigerisë, rrethana këto të

mjaftueshme se po të gjendet në liri mund të jetë i pakapshëm për organet e drejtësisë", thuhet në vendimin e gjykatës.

Haywood sërish MVP e javës në Superligë

PRIZREN, 27 SHKURT - Bashkimi ka regjistruar fitoren e 17 me radhë pasi që arriti të fitojë derbin ndaj Prishtinës me rezultat 70:80. Kësaj fitore më së shumti i kontribuoi Khadija Broën Haywood, e cila shënoi 24 pikë, nëntë kërcime dhe tri

asistime. Haywood ishte e saktë pesë herë nga dhjetë tentimet për tri pikë, ndërsa ishte e saktë 100 % nga gjuajtjet e lira, 3/3. Kjo bëri që të shpallet MVP e javës. Ajo u ndihmua nga Sara Vraniqi, e cila pati një performancë mjaft

të mirë, ku shënoi 18 pikë, kërcu nëntë herë dhe regjistroi një asistim. Fitore në udhëtim shënoi edhe Penza, që fitoi ndaj United Basketballit me rezultat 36:87. Më të mirat nga vajzat pejane ishin dyshja Leila Omerbasiq me 22 pikë, 14

kërcime dhe pesë asistime, si dhe qendra Saranda Daci me 13 pikë, 15 kërcime dhe pesë asistime.

Fitore të ngushtë regjistroi edhe Trepça ndaj Vëllaznimit me shifra 54:59. Më e mira te vajzat e "Minatorit" ishte amerikania



Marshanique Hall me 13 pikë, 12 kërcime dhe tri asistime.

Albin Krasniqi, 'Ylli i javës' në Superligë

FERIZAJ, 27 SHKURT - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 22-të në Albi Mall Superligë i ka takuar futbollistit të FC Ferizaj, Albin Krasniqi. Albini u vlerësua për paraqitjen e shkëlqyeshme që pati në fitoren tejet të rëndësishme dhe me peshë të FC Ferizaj në duel me pretendentin për titull, Dritën (2-1). Ai ishte asistues në të dyja golat e ferizajasve dhe plot kreativitet gjatë tërë ndeshjes, pasi të gjitha aksionet niseshin prej tij. Dëshmia më e mirë se Albin Krasniqi ishte më i miri është edhe statistika se ky lojtar ka vrapuar plot 12 kilometra në këtë ndeshje. "Ky çmim është shumë i rëndësishëm për mua sidomos në këtë moment kur dihet pozita në renditje në të cilën gjendet



skuadra ime. Më gëzon fakti se jemi në një seri pozitive dhe Ferizaj nga ndeshja në ndeshje po tregon lojë të mirë. Grupi është i motivuar dhe të gjithë bashkërisht po luftojmë në secilën sfidë për ta arritur objektivin tonë, mbetjen

në Albi Mall Superligë. Këtë çmim ua dedikoi bashkëlojtarëve, shtabit teknik, kryesisë dhe tifozëve, pasi secili prej tyre e ka vendin e rëndësishëm në këtë seri pozitive", ka theksuar Krasniqi për faqen zyrtare të FFK-së.

Portlandi mposhti Houstonin, lakersat 'leksion' Dallasit

PORTLAND, 27 SHKURT - Fitorja e tretë radhazi për lakersat, që triumfuan me rezultat 111-108 në fushën e rivalëve të Dallasit, duke iu afruar zonës "play-off". Anthony Davis me 30 pikë e 15 rebounde si dhe LeBron Jamesi me 26 pikë bënë diferencën në fushë, duke i bërë të pavlefshme 26 pikët e Donqiqit dh 21 të Irvingut. Ekipi i Denverit mbron kreun e renditjes në Perëndim pas fitores 134-124 ndaj



clippersave. Një tjetër ndeshje magjike për Nikola Jokiq, që realizoi 40 pikë, 17 rebounde e 10 asistime. Ndërsa 33 pikët e Leonardos mbetën për statistikë. Rikthehet te fitorja edhe skuadra e Golden States, që mundi me shifrat 109-104 Minnesotan. Tjetër ndeshje e mirë e Klay Thompsonit për kampionët, autor i 32 pikëve. Surpriza e mbrëmjes vjen nga

Damian Lillard, që realizoi 71 pikë në fitoren e Portlandit, 131-114 ndaj Houstonit. Ky është rekordi sezonal i pikëve të realizuara nga një basketbollist, me Lillardin që realizoi 13 gjuajtje të sakta nga distanca. Edhe pse pa Antetokounmpo, i dëmtuar, skuadra e Milwaukee's mundi me rezultat 104-101 Phoenixin (Jrue Holiday më i miri me 33 pikë).

REZULTATET

Milwaukee - Phoenix	104-101
Atlanta - Brooklyn	129-127
Chicago - Washington	102-82
Dallas - Lakers	108-111
Cleveland - Toronto	118-93
Oklahoma - Sacramento	115-124
Golden State - Minnesota	109-104
Portland - Houston	131-114
Denver - Clippers	134-124

Ibra: Nuk jam këtu për të luajtur vetëm 5-10 minuta

Në minutën e 74-t i gjithë "San Siro" në këmbë për ta përshëndetur Zlatan Ibrahimovićin, një homazh i denjë për një kampion të madh, të pamposhtur. Për herë të fundit ishte 22 maj 2022 kur Ibra zbriste në fushë, pas 280 ditësh gjiganti suedez

rikthehet të shijojë disa minuta. Ibra bëhet lojtari më i vjetër në historinë e Milanit që luan një ndeshje në Serinë A, 41 vjeç e 146 ditë duke thyer në këtë mënyrë rekordin e Alessandro Caostacurtas. "Më mungojnë shumë tifozët, më japin forcë dhe adrenalinë, pa

ata do të ishte e vështirë të rikthehesha në fushë. Ndihehem mirë. Në fakt kam 1 vit e dy muaj që nuk ndihem si sot. Sot jam i lirë të bëj atë që dashuroj, të luaj futboll. Kam vuajtur shumë 6 muajt e fundit. Doja ta ndihmoja ekipin me çdo kusht, po e kisha të pamundur,

isha i pafuqishëm për ta bërë. I kisha bërë një premtim trajnerit se nuk do të'i nënshtrohesha operacionit pa fituar trofe, nuk kisha vuajtur kurrë kaq shumë për të fituar një trofe. Gjithsesi, nuk jam këtu për atë që kam bërë në të kaluarën, jam këtu për të

konkurruar me kolegët e mi për të luajtur. Nëse do të ishte për të luajtur 5-10 minuta më mirë qëndroja në shtëpi. Jam këtu për të luajtur të gjithë ndeshjen", ka thënë Ibra duke theksuar në fund se ka ulur rrogën e tij vetëm që Leao të qëndrojë.

SHKURT

Veteli mund ta zë vendin e Strollit

Piloti gjerman Sebastian Vettel mund të zbrisë këtë fundjavë në pistë në garën e parë sezonale të Formulës 1 që zhvillohet në Bahrein. Katër herë kampioni i botës mund ta zërë vendin e kanadezit Lance Stroll te skuadra e Aston Martinit, i dëmtuar një javë më parë teksa shëtiste me biçikletë. Stroll nuk mori pjesë në testet dimërore të zhvilluara javën e kaluar në Bahrein dhe prania e tij në garën hapëse të botërorit është në dilemë. Për pasojë, skuadra e Aston Martinit mund ta kërkojë sërish ndihmën e Vettelit, që e ka pilotuar këtë makinë deri sezonin e kaluar para se të tërhiqej nga garat. Makina Aston Martin ka deklaruar se sot ose nesër do ta bëjë publike vendimin në lidhje me Lance Stoll, por fakti që përmendet emri i Vettelit është mjaft i rëndësishëm. Piloti tjetër i Aston Martin është sërish një kampion bote, Fernando Alonso, ndaj në start mund të kemi një dyshe kampionësh.

Klinsmanni, trajner i Koresë së Jugut

Trajneri gjerman Jurgen Klinsmann ka arritur marrëveshje me Federatën e Futbollit të Koresë së Jugut dhe do të jetë trajneri i kombëtares aziatike me një kontratë deri në Botërorin e vitit 2026. Ish-sulmuesi gjerman ka drejtuar Gjermaninë më parë dhe ShBA-në, ndërsa ka qenë edhe trajner i klubeve të Bayern Munchenit dhe Hertha Berlinit.

Ten Hag: Këta janë tre lojtarët që ndikuan në rilindjen e Unitedit

Manchester Unitedi ka fituar trofeun e parë sezonal, pasi në finalen e EFL Cup ka triumfuar ndaj Newcastle Unitedit (2-0). Me ardhjen e trajnerit Erik Ten Hag gjërat janë përmirësuar ndjeshëm te "Djajtë e Kuq" dhe holandezi është i lumtur për këtë gjë. Kur u pyet se cilët janë tre futbollistët kyç për rilindjen e Unitedit, Ten Hag nuk ngurroi t'i tregonte emrat e tyre. "David De Gea, Raphael Varane dhe Casemiro. Është e nevojshme të kesh lojtarë të tillë për ta udhëhequr skuadrën. Ata më shërbejnë dhe ndihmojnë edhe mua si trajner. Nuk flas vetëm në aspektin teknik, por sidomos për mentalitetin fitues që sjellin në dhomat e zhvishjes. Këtu ekziston një uri e madhe për trofe, pasi Unitedi është mësuar të fitojë gjithmonë", ka thënë Ten Hag.

Xavi: Ishte ndeshja më e keqe e sezonit

Trajneri i Barcelonës, Xavi Hernandez, ka vlerësuar se humbja në fundjavë nga Almeria ka qenë ndeshja më e keqe e sezonit nga Barça. "Ishte ndeshja më e keqe e sezonit. Jam tejet i zemëruar, nuk ka arsytim dhe dua t'u kërkoj falje tifozëve. Nëse nuk ndryshojmë në aspektin psikik, do të na kushtojë në fund me titull. Humbëm një rast të artë, nuk e kemi fituar ligën që tre vjet. Nuk e kuptoj. Do të ngrihem sërish, por nuk do ta fitojmë ligën në mënyrë të rehatshme. Do të garojmë me Real Madridin, fituesin e fundit të ligës dhe Ligës së Kampionëve", ka thënë Xavi. Barcelona mbetet lidere në tabelë me 59 pikë, shtatë më shumë se Real Madridi që renditet në pozitën e dytë.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “SPV DARDANIA” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811912676 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “SPV DARDANIA” D.O.O. Pristine, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811912676 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “SPV DARDANIA” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 811912676 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Argjentina Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Dr. Ali Sokoli” Prishtinë.

- Fetah Zabelaj B.I. emri Tregtar Auto-Taxi Fetah Zabelaj shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr Unik Identifikues 810318792 nrb. 80326394.

- Shpend Kumnova nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X,XI,XII dhe diplomën e Gjimnazit “Hjadar Dushi” Gjakovë.

- Kristian Nikolla nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Musa Smajlaj nga Jabllanica KK Gjakovë shpall të pavlefshme certifikatën për muratorë lëshuar nga Q.A.P. Pejë.

- Samir Shala shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Fadil Hisari " Prizren.

- Makfire Gashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " 17 Shkurti " Hatmaxhe.

- Ivica Dimic shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Marigona Musli Mejzinolli shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit AAB Prishtinë drejtimi Psikologji Bachelor me nr. 1640/18.

- Drin Jakurti nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hjadar Dushi” Gjakovë.

- Shkelqim Rexha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shfmu “Yll Morina” Gjakovë nga kl.I-IX.

- Qëndrim Haziri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hjadar Dushi” Gjakovë.

- Shkelqim Rexha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shfmu “Mustafa Bakija” nga kl. I-V Gjakovë.

- Shqipe Mazreku nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën diplomën e shm Mjekësisë “Hysni Zajmi”.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

